



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/136  
Datë: 22/9/2022

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23, paragrafi 1.6, paragrafi 1.6.2 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 6.9.2022, miratoi:

**RREGULLORE**

***Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 2/543, datë 22.10.2021, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"***

**Neni 1**

**Qëllimi dhe përkufizimet**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores me nr. prot. 2/543, datë 22.10.2021, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"
2. Përkufizimet në kuadër të kësaj rregulloreje mbesin të njëjta siç janë përcaktuar në Rregulloren me nr. prot. 2/543, datë 22.10.2021, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".
3. Rregullorja me nr. prot. 2/543, për nevoja të kësaj rregulloreje nënkupton Rregullores me nr. prot. 2/543, datë 22.10.2021, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" (rregullorja bazike).

**Neni 2**

**Marrëdhënia e punës e personelit akademik sipas normës**

1. Paragrafi 5 i nenit 4 të rregullores bazike riformulohet si vijon:
  - 1.1. Personelit akademik që i ka skaduar kontrata e punës (kategorisë së mësimdhënësve sipas nenit 176 dhe 177 të Statutit në kohëzgjatje prej 4 vitesh, kurse asistentëve dhe lektorëve sipas nenit 178 dhe 179 në kohëzgjatje prej 3 vitesh), si pasojë e shtyrjes së hapjes së konkursit për shkak të rrethanave objektive jashtë vullnetit të tij, përkatësisht vonësave në përfundimin e procedurave të rizgjedhjes apo avancimit, i vazhdohet kontrata në thirrjen aktuale deri në përmbylljen e procedurave të konkursit të radhës të

shpallur pas skadimit të kontratës përkatësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e senatit lidhur me konkursin në cilin ka aplikuar kandidati.

### **Neni 3**

#### **Sanksionet financiare për mospërmbushje të detyrave**

1. Paragrafi 2 i nenit 6 të rregullores bazike riformulohet si vijon:
  - 1.1. Dekani i njësisë akademike obligohet që të procedojë tek zyra për financa e UP-së për zbatim sanksionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni. Nëse dekani nuk raporton për orët e humbura ose për mosmbajtje të provimit brenda afatit të shpallur do të sanksionohet me 50% të vlerës së shtesës funksionale.
2. Paragrafi 3 i nenit 6 të rregullores bazike, riformulohet si vijon:
  - 2.1. Personeli akademik dhe menaxhues sanksionohet me heqje 10% të pagës bazë, nëse ai/ajo nuk merr pjesë pa arsye në tri (3) mbledhje të senatit, kolegjum të dekanëve, këshill të fakultetit, departamente dhe në komisione radhazi, në të cilat është emëruar nga organet e UP-së apo njësitë akademike.
3. Paragrafi 4 i nenit 6 të rregullores bazike, riformulohet si vijon:
  - 3.1. Rektori për anëtarët e senatit, kolegjumit të dekanëve, respektivisht për personelin akademik pas raportimit nga dekani i njësisë akademike, obligohet që të zbatojë sanksionet e përcaktuara sipas paragrafit 3 të nenit 6 të rregullores bazike, respektivisht paragrafit 2 të këtij neni.

### **Neni 4**

#### **Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik**

1. Paragrafi 4 i nenit 7 të rregullores bazike riformulohet si vijon:
  - 1.1. Përfundimisht nga Tabela 1 e këtij neni, për personelin akademik të punësuar në Fakultetin e Arteve, norma javore e orëve do të jetë si në vijim:
    - 1.1.1. Mësimdhënësit: 8 orë në javë;
    - 1.1.2. Asistentët: 16 orë në javë.
2. Paragrafi 6 i nenit 7 të rregullores bazike riformulohet si vijon:
  - 2.1. Me qëllim të kompensimit dhe implikimeve buxhetore, kusht për shpalljen e konkursit për vendet e reja në UP, për mësimdhënëses, asistent, lektorë dhe korepetitorë është plotësimi i së paku 50% të orëve të parapara me normë të plotë në lëndët obligative, kurse pjesa tjetër në lëndët zgjedhore. Përfundimisht, në rastet kur fondi i orëve në fushën e caktuar nuk mund të plotësohet me orë të ligjëratave, në Fakultetin e Mjekësisë konkursi mund të shpallet edhe në rastin kur në fushën e caktuar brenda vitit akademik plotësohet fondi prej së paku 8 orë ligjëratave ndërsa orët tjera mund të plotësohen me ushtrime. Ushtrimet duhet të janë në lëndët për ligjëratat e të cilave është duke u shpallur konkursi. Edhe në këtë rast së paku 50% e ligjëratave përkatësisht 4 orë

duhet ti takojnë lëndëve obligative, ndërsa pjesa tjetër mund të mbulohen me ligjërata nga lëndët zgjedhore. Në Fakultetin e Mjekësisë, në kuadër të numrit të nevojshëm të orëve, mund të përfshihen edhe orët nga praktika klinike. Norma e plotë llogaritet për një vit akademik.

3. Pas paragrafi 6 të nenit 7 të rregullores bazike shtohen paragrafët vijues:
  - 3.1. Në rastet kur dëshmohet se ekziston rreziku i humbjes së akreditimit për programin e caktuar, paragrafi 2.1 i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht edhe për Fakultete tjera të cilat në kuadër të programeve të tilla ofrojnë ushtrimet numerike, laboratorike ose klinike.
  - 3.2. Plotësimi i orëve të nevojshme mësimore për shpalljen e konkursit për mësimdhënës si në paragrafin 2.1 dhe 2.2 të këtij neni nuk mund të bëhet me orë të ligjëratave nga norma e mësimdhënësve të cilët tashmë janë të emëruar, përkatësisht nëpërmjet zëvendësimit të orëve të ligjëratave të mësimdhënësve tashmë të emëruar me orë të ushtrimeve.
4. Paragrafët 7 dhe 8 të nenit 7 të rregullores bazike bëhen paragrafë 9 dhe 10:

#### **Neni 5**

#### **Kompensimi për orët mbi normë të personelit akademik**

1. Paragrafi 4 i nenit 8 të rregullores bazike riformulohet si në vijim:
  - 1.1. Mësimdhënësi në marrëdhënie të rregullt pune, sipas vlerësimit të njësisë akademike përkatëse dhe duke pasur parasysh nevojat, mund të mbajë orë mbi normë edhe ushtrime, por jo më shumë se 3 orë në javë brenda semestrit përkatës, të cilat kompensohen si orë të ligjëratave, ashtu siç është përcaktuar në këtë rregullore. Mbinorma në këtë rast duhet të arsyetohet nga dekani i njësisë akademike dhe të miratohet nga rektori si dhe nuk mund të tejkalojë limitin e mbinormës që është përcaktuar me këtë rregullore. Mbinorma me ushtrime mund të llogaritet vetëm pasi mësimdhënësi ta ketë plotësuar normën me ligjërata dhe vetëm atëherë kur orët përkatëse nuk mund të mbulohen nga asistentët.
2. Paragrafi 5 i nenit 8 të rregullores bazike riformulohet si vijon:
  - 2.1. Orët mbi normë nuk mund të barten prej një semestri në semestrin tjetër. Me rastin e caktimit dhe kompensimit të mbi normës për vitin akademik, paraprakisht duhet të plotësohet norma për vit akademik. Pasi të jetë plotësuar norma e personelit akademik në kuadër të programit/departamentit (për mësimdhënësit me ligjërata, për asistentët me ushtrime), orët e mbetura mund të kompensohen si orë mbi normë. Në secilin rast, orët mbinormë nuk mund të kompensohen nëse paraprakisht nuk janë shpallur në konkurset përkatëse për personel të rregullt ose për bashkëpunëtor të jashtëm.

**Neni 6**  
**Punimi i diplomës baçelor dhe master në kuadër të normës**

1. Tabelat 3 dhe 4 që ndërlidhen me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 9 të rregullores bazike ndryshohen si në vijim:

**Tabela 3. Numri i punimeve të diplomës baçelor**

<b>Njësia akademike/ Fakulteti</b>	<b>Mentor</b>	<b>Kryetar dhe anëtar</b>
Fakulteti Filozofik	7	14
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	2	7
Fakulteti i Filologjisë	7	14
Fakulteti Juridik	7	14
Fakulteti Ekonomik	7	14
Fakulteti i Ndërtimtarisë	2	7
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	2	7
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	2	7
Fakulteti i Mjekësisë	2	7
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	2	7
Fakulteti i Arteve	2	7
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	2	7
Edukim	7	14
Arkitekturë	2	7

**Tabela 4. Numri i punimeve të diplomës master**

<b>Njësia akademike/ Fakulteti</b>	<b>Mentor</b>	<b>Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>
Fakulteti Filozofik	2	1	2
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	1	1	2
Fakulteti i Filologjisë	2	1	2
Fakulteti Juridik	2	1	2
Fakulteti Ekonomik	2	1	2
Fakulteti i Ndërtimtarisë	1	1	2
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	1	1	2
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1	1	2
Fakulteti i Mjekësisë	1	1	2
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	1	1	2
Fakulteti i Arteve	1	1	2
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	1	1	2
Fakulteti Filozofik	2	1	2
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	1	1	2

2. Neni 9 i rregullores bazike plotësohet me paragrafin 6, si në vijim:

- 2.1. Llogaritja e numrit të punimeve të diplomës në studimet baçelor dhe master në kuadër të normës brenda vitit akademik, të përcaktuara në tabelën 3 dhe 4, vlenë edhe për mësimdhënësit e pensionuar, si dhe për personelin akademik të angazhuar.

## Neni 7

### Punimet e diplomës baçelor dhe master në kuadër të mbinormës

1. Paragrafi 7 i nenit 10 të rregullores bazike riformulohet si vijon:

1.1. Kompensimi i temave baçelor dhe master në kuadër të mbinormës bëhet pas mbrojtjes së temës, duke llogaritur numrin e tërësishëm të temave në kuadër të normës dhe mbinormës, pa marrë parasysh vitin akademik kur është nxjerrë vendimi për lejimin e temave përkatëse. Me rastin e kompensimit, pas mbrojtjes, merret parasysh vendimi për lejimin e temës.

2. Neni 10 i rregullores bazike plotësohet me paragrafin 9, si në vijim:

2.1. Llogaritja e numrit të punimeve të diplomës në studimet baçelor dhe master në kuadër të mbinormës brenda vitit akademik, të përcaktuara në tabelën 5 dhe 6 vlenë edhe për mësimdhënsin e pensionuar, si dhe për personelin akademik të angazhuar.

## Neni 8

### Kompensimi për punimet e diplomës të studimeve master

1. Paragrafi 2 i nenit 19 i rregullores bazike riformulohet si vijon:

1.1. Mentori i emëruar nuk kompensohet edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit për vlerësimin përkatësisht mbrojtjen e temës. Mësimdhënësi i emëruar në cilësinë e kryetarit/anëtarit të komisionit për vlerësimin e temës dhe në cilësinë e kryetarit/anëtarit të komisionit për mbrojtje, kompensohet vetëm njëherë për pozitën e cila ka kompensimin më të lartë.

## Neni 9

### Kompensimi për punimet e diplomës në studimet e doktoratës

1. Paragrafi 1 i nenit 20 të rregullores bazike riformulohet si vijon:

1.1. Kompensimi për mentorin dhe komisionet e doktoratës bëhet sipas tabelës 11.

**Tabela 11.**

Nr. rendor	Emërtimi i komisionit	Kompensimi në vlerën bruto
1	Për mentorin e disertacionit të doktoratës	1,200.00 €
2	Për kryetar të komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës	250.00 €
3	Për anëtar të komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës	200.00 €
4	Për kryetar të komisionit për mbrojtje të disertacionit të doktoratës	200.00 €
5	Për anëtar të komisionit për mbrojtje të disertacionit të doktoratës	150.00 €

2. Neni 20 i rregullores bazike plotësohet me paragrafin 8 si vijon:

2.1. Mësimdhënësi i emëruar në cilësinë e kryetarit/anëtarit të komisionit për vlerësimin përkatësisht mbrojtjen e temës dhe në cilësinë e kryetarit/anëtarit të komisionit për mbrojtje, kompensohet vetëm njëherë për pozitën e cila ka kompensimin më të lartë.

#### Neni 10

#### Kompensimi për orët e mbajtura në studimet e doktoratës

1. Paragrafi 1 i nenit 21 të rregullores bazike riformulohet si vijon:

1.1. Orët e mbajtura në studimet e doktoratës llogariten në kuadër të normës dhe mbinormës, të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje. Pagesat për orët e mbinormës në kuadër të studimeve të doktoratës kompensohen në vlerën 50 euro për orë.

#### Neni 11

#### Krijimi i grupeve në studimet baçelor

Tabelat 13, 14 dhe 15 që përfshihen në kuadër të nenit 25 të rregullores bazike ndryshohen si në vijim:

**Tabela 13.**

#### Grupi i parë

	Ligjërata	Ushtrime
F. Filozofik	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 80 <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min: 10 max: 80 Zgjedhore: min: 5 max: 50	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 20
F. Filologjik	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 80 <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min: 10 max: 80 Zgjedhore: min: 5 max: 50	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 20
F. Juridik	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 80 <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min: 10 max: 80 Zgjedhore: min: 5 max: 50	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 30

F. Ekonomik	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 80	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 30
	<b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min: 10 max: 80 Zgjedhore: min: 5 max: 50	

**Tabela 14.**  
**Grupi i dytë**

	Ligjërata	Ushtrime (Teorike)	Ushtrime (Laboratorike)
FSHMN	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40  <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min 10- max: 50 Zgjedhore: min 5- max: 25	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
F. Ndërtimtarisë	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40  <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min 10- max: 50 Zgjedhore: min 5- max: 25	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
F. Arkitekturës	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40  <b>Viti III, IV dhe V</b> Obligative: min 10- max: 50 Zgjedhore: min 5- max: 25	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max
FIEK	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40  <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min 10- max: 50 Zgjedhore: min 5- max: 25	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
FIM	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12

	<b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min 10- max: 50 Zgjedhore: min 5- max: 25		
F. Edukimit	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40  <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min 10- max: 50 Zgjedhore: min 5- max: 25	Obligative/Zgjedhore min: 10-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12

**Tabela 15.**  
**Grupi i tretë**

	Ligjërata	Ushtrime (Teorike)	Ushtrime (Laboratorike /Klinike/Fizike)
F. Mjekësisë	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 50 Zgjedhore: min: 5 max: 40  <b>Viti III, IV, V dhe VI</b> Obligative: min: 10 max: 30 Zgjedhore: min: 5 max: 30	Obligative/Zgjedhore min: 5- max-25	Lab. Obligative/Zgjedhore: min 5 – max-10 Klinike, Obligative/Zgjedhore min: 4- max-8
F.B.V	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 50 Zgjedhore: min: 5 max: 30  <b>Viti III , IV dhe V</b> Obligative: min: 10 max: 40 Zgjedhore: min: 5 max: 30	Obligative/Zgjedhore min: 5- max-25	Lab. Obligative/Zgjedhore min: 5- max-10 Klinike, Obligative/Zgjedhore min: 4- max-8
F. Arteve	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 1 max: 60 Zgjedhore: min: 1 max: 40  <b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min: 1 max: 40 Zgjedhore: min: 1 max: 30	Obligative/Zgjedhore min: 1- max-25	/

FEFS	<b>Viti I dhe II</b> Obligative: min: 10 max: 60 Zgjedhore: min: 5 max: 40	Oblig./Zgjedhore 5 deri 25	Fizike: Oblig./Zgjedh. 5 deri 10
	<b>Viti III dhe IV</b> Obligative: min: 10 max: 40 Zgjedhore: min: 5 max: 30		

**Vërejtje:** Grupet e reja të studentëve mund të formohen pasi të kalohet numri maksimal për grup i specifikuar në tabelat 13, 14 dhe 15.

## Neni 12

### Grupet e ligjëratave dhe ushtrimeve, në studimet master

Tabelat 16, 17 dhe 18 që përfshihen në kuadër të nenit 26 të rregullores bazike ndryshohen si në vijim:

**Tabela 16.**  
**Grupi i parë**

	Ligjërata (Oblig.)	Ligjërata (Zgjedh.)	Ushtrime (Oblig./Zgjedh.)
F. Filozofik	Min. 5-Max. 40	Min. 5-Max. 20	Deri 20
F. Filologjik	Min. 5-Max. 40	Min. 5-Max. 20	Deri 20
F. Juridik	Min. 5-Max. 40	Min. 5-Max. 20	Deri 20
F. Ekonomik	Min. 5-Max. 40	Min. 5-Max. 20	Deri 20

**Tabela 17.**  
**Grupi i dytë**

	Ligjërata (Oblig./Zgjedh.)	Ushtrime	
		Teorike	Laboratorike
FSHMN	Min. 5-Max 35	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
F. i Ndërtimtarisë	Min. 5-Max 35	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
F. i Arkitekturës	Min. 5-Max 35	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
FIEK	Min. 5-Max 35	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
FIM	Min. 5-Max 35	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
F. i Edukimit	Min. 5-Max 35	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15

**Tabela 18.**  
**Grupi i tretë**

	Ligjërata (Oblig./Zgjedh.)	Ushtrime		
		Teorike	Laboratorike /Fizike	Klinike
F. Mjekësisë	Min. 5-Max 30	Obligative/Zgjedhore, 5 deri 15	Obligative/Zgjedhore, deri 10	Obligative/Zgjedhore, deri 8
FBV	Min. 5-Max 30	Obligative/Zgjedhore, 5 deri 15	Obligative/Zgjedhore, deri 10	Obligative/Zgjedhore, deri 8
F. Arteve	Deri 25	/	/	/
FEFS	Min. 5-Max 30	Obligative/Zgjedhore, 5 deri 15	Obligative/Zgjedhore, deri 10	/

**Vërejtje:** Grupet e reja të studentëve mund të formohen pasi të kalohet numri maksimal për grup i specifikuar në tabelat 16, 17 dhe 18.

### Neni 13


#### Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtura

1. Fusnota 3, ndërlidhur me paragrafin 1 të nenit 27 të rregullores bazike riformulohet si në vijim:
  - 1.1. Në këtë rast “rrethanë objektive” konsiderohet ndërprerja e energjisë elektrike dhe problemet eventuale në SEMS dhe pajisjet e SEMS në salla, të cilat konstatohen nga
  - 1.2. zyra për teknologji të informacionit në UP.
  - 1.2. Paragrafi 6 i nenit 27 fshihet dhe kështu paragrafi 7 i nenit 27 të rregullores bazike bëhet 6, paragrafi 8 bëhet 7 e kështu me radhë.

### Neni 14

#### Dispozitat kalimtare

1. Në të gjitha rastet kur rregullorja bazike i referohet tabelave 3, 4, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 në të gjitha dispozitat, duhet të aplikohen tabelat respektive të ndryshuara sipas kësaj rregulloreje.
2. Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohen dispozitat përkatëse të rregullores bazike, të plotësuara dhe të ndryshuara në këtë rregullore.
3. Kjo rregullore fillon të zbatohet duke filluar nga viti akademik 2022/23.



**Dr. Arbëresha Nela-Turjaka**

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UP-së